



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2025:016075
Datë: 28.02.2025
Numri i dokumentit: 06919613

NË EMËR TË POPULLIT

K.nr.48/25

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE DEGA LIPJAN – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, sipas gjyqtarit Selman Salihu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Vesa Bajrami, duke vendosur në procedurë kundërvajtëse kundër të pandehurit S. Sh. nga fsh.B. i Z. K.L., për vepër të kundërvajtjes nga neni 249 par. 2 të Ligjit 08/L-186 për rregullat e trafikut rrugor, e në bazë të neneve 27, 55, 56, 77 par.1.1, nenit 127 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datën 24.02.2025 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

S. Sh., nga i ati Shaban, i lindur me dt.... në fsh.B.i Z. K.L., ku edhe jeton, i martuar, ka të kryer fakultetin juridik, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse:

Me datën 27.12.2024 rreth orës 11:05h, ne rr.L.-Sh. në fsh.G. L. ka ndodhur aksidenti i trafikut ku sipas shiqimit te vendin te ngjarjes, pikës se kontaktit ne mes te dy automjeteve dhe pozitën përfundimtare te automjeteve si dhe deklaratave te dy drejtuesve te automjeteve deri te aksident trafiku dyshohet se ka ardhur kur drejtuesi i automjetit "A" merr veprim pa u bindur qe pengon apo rrezikon pjesëmarrësit tjerë ne komunikacion, veprim kuqje ne rruge ne mënyre te pa sigurte nga një parking i auto larjes S. W. për ne rrugën L. Sh. dhe e pengon automjetin "B" i cili ishte duke lëvizur ne rrugën sh.-L. dhe me pa mundësi qe te ndalet me pjesën e parme e goditë automjetin "A" ne pjesën e parme anësorë te anës se majte e cila përfundon jashtë rrugësi. Ne këtë aksident pos dëmeve materiale qe janë shkaktuar ne te dy automjetet lëndime trupore ka pësuar drejtuesja e automjetit "B" ku pas trajtimit mjekësor është liruar për ne shtëpi.

-Me këtë ka kryer vepër kundërvajtëse nga neni 249 par. 2 të Ligjit 08/L-186 për rregullat e trafikut rrugor, e në bazë të të njejtit nen dhe ligj të pandehurin e,

G J Y K O N

Me denim me gjobë në shume prej 100-€ (njëqindeuro), të cilën gjobë i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotefuqishmerisë së këtij aktgjykimi për Buxhetin e Kosovës, fletpagesa merret në lokalet e kësaj gjykate e njehta vlen edhe për paushallin gjyqësor.

Obligohet i pandehuri që në emer te paushallit gjyqësor kësaj gjykate të i'a paguaj shumën prej 5-€ në afat prej 15 ditësh pas plotefuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse gjobën dhe paushallin nuk i paguan në afatin e dhënë në vështrim të nenit 163 par 4 të LK-së arketimi do te bëhet sipas dispozitave për arkëtimin me dhunë të tatimit.

A r s y e t i m

NJRKRR- Prishtinë me kërkesën me nr. të lëndës 2024-AR-3835 të dt.27.01.2025 ka kërkuar për zhvillimin e procedurës kundërvajtës kundër të pandehurit, për veprë te kundërvajtjes të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ne baze te kerkeses se parashtruar ka marre ne pyetje te pandehurin i cili gjatë marrjes ne pyetje ka deklaruar se e ndin veten pergjegjës per veprën kundervajtese qe i vihet ne barre te pershkruar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata e mbeshtetur ne kerkesen e parashtruar e duke administruar dhe vlerësuar provat veq e veq dhe te gjitha bashkarisht sipas bindjes se lire kostaton se është vërtetuar ne mase te mjaftuar se ne veprimet e te pandehurës ekzistojne elementet dhe tiparet e vepres kundervajtëse te nga neni 249 par.2 i LRRTRR-së.

Gjykata beri zbutjen e denimit ndaj te pandehurit duke aplikuar dispozitat e nenit 35 te LK-së.

Me rastin e marrjes se ketij aktgjykimi gjykata pati parasyshe rrethanat lehtesuese dhe renduese te kryerjes se vepres kundervajtese, sjelljet e të pandehurit pas kryerjes se veprës kundervajtëse, shkallën e përgjegjesisë, pendimin për kryerjen një kundërvajtje të tillë, duke shpresuar se me këtë ka arritur qëllimi i dënimit dhe se do te kete efekt pozitiv qe ne te ardhmen ti shmanget kryerjes se kundervajtjeve te njejte apo te ngjashme.

Nga arsyet e cekura me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTINE DEGA NE LIPJAN

K.nr. 48/25 te dt. 24.02.2025

**Gjyqtari
Selman Salih**

KËSHILLA JURIDIKE;

Kundër këtij aktgjykimi palet kane te drejte ankese ne afatin prej 8 ditesh nga dita e pranimit te te njejtes.Gjykata se Apelit –divizioni I kundervajtjes ne Prishtine permes kesaj gjykate pa taksa.